



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

Nr. 7864 Prot. Dt 11.11.2013

Nr. 3095 Prot. Dt 11.11.2013

SHËRBIMI INFORMATIV I SHTETIT

Nr. 2207 Prot. Dt 11.11.2013

MEMORANDUM

Të vetëdijshëm për nevojën dhe rëndësinë e bashkëpunimit të organeve të zbatimit të ligjit në luftën kundër të gjitha formave të kriminalitetit;

Duke vlerësuar se lufta kundër krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme, krimeve të rënda, korrupsionit dhe veprave penale që çenojnë rregjimin juridik të tokës, mjedisin dhe burimet natyrore, është përcaktuar si prioritet i veprimit të tyre;

Të ndërgjegjshëm se shembja e murit të pandëshkueshmërisë dhe rezultatet konkrete në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, janë themelore për forcimin e shtetit ligjor, barazisë para ligjit dhe rritjes së besimit të publikut ndaj ligjit, drejtësisë dhe institucioneve;

Të bindur se bashkëpunimi ndër-institucional është vendimtar në arritjen e objektivave të përbashkëta;

Bazuar në:

- Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë.
- Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.
- Ligjin nr.9737, datë 12.02.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligjin nr.8391, datë 28.10.1998, "Për Shërbimin Informativ", i ndryshuar.

- Ligjin nr.9749, datë 04.06.2007, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar.
- Ligjin nr.8457, datë 11.02.1999, "Për informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror", i ndryshuar

Ministria e Punëve të Brendshme, Prokuroria e Përgjithshme dhe Shërbimi Informativ Shtetëror, që këtej e tutje referuar si "Palët", bien dakort që bashkëpunimi të zhvillohet në:

Nivel Qendror ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Shërbimit Informativ Shtetëror.

Në nivel Vendor ndërmjet Drejtorive të Policisë në Qarqe dhe Komisariatet, Prokurorive pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore dhe Shërbimit Informativ të Shtetit në Qarqe.

Palët nënshkruajnë këtë Memorandum:

Neni 1

Objekti

1. Objekti i këtij Memorandumi është forcimi i bashkëpunimit dhe bashkërendimit të veprimtarisë së tre institucioneve në parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar (trafiqeve të paligjshme), krimeve të rënda, korrupsionit dhe veprave penale që çënojnë rregjimin juridik të tokës, mjedisit dhe burimet natyrore.
2. Forcimi i bashkëpunimit në punën e tre institucioneve, Shërbimit Informativ Shtetëror si organ informativ, Ministrisë së Punëve të Brendshme si organ ekzekutiv, Prokurorisë si organ i ndjekjes penale dhe hetimit, do t'i shërbejnë gjithmonë zbatimit të drejtë të ligjit për të rritur efektivitetin e goditjes së veprimtarisë kriminale, pa ndërhyrë në kompetencat e njëri tjetrit.

Neni 2

Fushat e bashkëpunimit

1. Në kuadër të këtij Memorandumi, Palët do të bashkëpunojnë në zbulimin, parandalimin dhe hetimin e veprimtarisë kriminale sipas fushave:
 - krimi i organizuar (trafiqet e paligjshme)
 - krimet e rënda,

- korrupsioni,
 - vepra penale që çënojnë rregjimin juridik të tokës, mjedisin dhe burimet natyrore.
2. Në fushën e korrupsionit, synohet forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet palëve, të afirmuar dhe konsoliduar me Memorandumin e Bashkëpunimit të datës 06.05.2009, ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Financave, Shërbimit Informativ Shtetëror, Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit, pa cënuar detyrimet e përcaktuara në të.

Neni 3

Detyrime të përbashkëta

Palët angazhohen të:

a) marrin masa për:

- i. mbledhjen e informacionit në lidhje me personat fizik e juridik të përfshirë në veprimtarinë kriminale sipas fushës së përcaktuar në nenin 2, të këtij Memorandumi;
- ii. verifikimin dhe vlerësimin me përgjegjësi të çdo indicie për veprimtari të kundraligjshme në funksion të grumbullimit të dokumenteve dhe provave në interes të hetimit;
- iii. verifikimin dhe analizimin e informacionit që shkëmbehet ndërmjet Palëve;
- iv. plotësimin e rregullt të kallëzimeve penale dhe materialeve të tjera proceduriale;
- v. ruajtjen dhe mos bërjen publike të informatave dhe burimeve të tyre, veprime hetimore, provave, akteve dhe/ose të dhënave të tjera, deri në përfundim të hetimeve paraprake.
- vi. kryerjen me profesionalizëm të veprimeve proceduriale në interes të procesit hetimor në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale;
- vii. kryerjen e hetimeve paraprake, zbulimin e plotë të veprimtarisë kriminale të autoreve, ngritjen dhe përfaqësimin e akuzës, në afate sa më të shpejta dhe kërkimin e sanksioneve të rënda penale në gjykatë;

- viii. përdorimin e metodave speciale të hetimit dhe hetimeve proaktive në interes të një procesi hetimor sa më të shpejtë dhe cilësor;
 - ix. vënien përpara përgjegjësisë penale, në rast të konstatimit të kryerjes ose mos kryerjes së veprimeve në kundërshtim me ligjin të punonjësve, që ligji specifik i fushës i ngarkon me detyrimin për zbatimin e tij.
- b) rrisin bashkëpunimin për shkëmbimin e informacionit ndërmjet tyre me qëllim parandalimin dhe zbulimin e shpejtë të veprave penale në fushat e përcaktuara në nenin 2, të këtij Memorandumi dhe në mënyrë të veçantë garantojnë shkëmbimin në kohë reale të informacionit për çështje sensitive;
 - c) zbatojnë standarde për mbrojtjen, sigurinë dhe fshehtësinë e të dhënave dhe përdorin kanale të sigurta komunikimi për shkëmbimin e informacionit;
 - d) organizojnë dhe zhvillojnë trajnime të përbashkëta për rritjen e kapaciteteve investiguese dhe orientimin e këtyre strukturave drejt inteligjencës;
 - e) shfrytëzojnë burimet njerëzore, materiale dhe eksperiencat e secilës palë, në interes të parandalimit, zbulimit dhe hetimit;
 - f) bashkëpunojnë më realisht në nivel qendror dhe vendor me institucionet shtetërore, organet e qeverisjes vendore dhe aktorë të tjerë që kanë detyrime sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 4

Takime të Përbashkëta

1. Çdo 6 muaj titullarët e të tre institucioneve, do të takohen për të diskutuar ecurinë e implementimit të këtij Memorandumi me qëllim që të ndërtohet një politikë goditjeje sa më efikase, duke përcaktuar dhe drejtimit për të realizuar me sukses këtë luftë.
2. Drejtuesit e strukturave vendore të të tre institucioneve, të organizojnë mbledhje pune periodike, ku të parashtrihen dhe analizohen problematikat në kuadrin e bashkëpunimit për secilën fushë, objekt i këtij Memorandumi.
3. Me iniciativën e secilës Palë, për probleme të caktuara, takimet mund të bëhen në çdo kohë në të gjitha nivelet.

4. Në mbledhjet e organizuara krahas pranisë së titullarëve të tre institucioneve, sipas rëndësisë së problemit, mund të ftohen të marrin pjesë punonjës të sektorëve përkatës, sipas çështjeve që trajtohen.
5. Objekt i punës së këtyre mbledhjeve, si në qendër dhe në baze të jenë trajtimi dhe analizimi i çështjeve të tilla, si lufta kundër krimit të organizuar e veçanërisht trafikëve të paligjshme, krimeve të rënda, korrupsionit dhe veprave penale që cënojnë rregjimin juridik të tokës, mjedisit dhe burimet natyrore, me qëllim që të përcaktohen rrugët dhe detyrat konkrete për organizimin, bashkëpunimin e bashkërendimin midis tre institucioneve.
6. Çështje prioritarë për diskutim të jenë vënia në dukje e të metave dhe dobësive duke nxjerrë përgjegjësitë për çdo organ, si dhe duke përcaktuar drejtimit për përmirësimin dhe organizimin e punës.
7. Konkluzionet e mbledhjeve dhe problemet e evidentuara t'u bëhen të njohura në mbledhje të veçanta punonjësve të bazës të secilit organ sipas drejtimeve në mënyrë që nëpërmjet njohjes së tyre të përcaktohen masa konkrete për mënjanimin e të metave dhe përmirësimin e punës.
8. Drejtuesit e strukturave përkatëse njohin me konkluzionet e takimeve të zhvilluara sipas pikës 2, të këtij neni, titullarët e institucioneve respektive.
9. Në zbatim të detyrave procedurale dhe të atyre të caktuara me ligj, të tre institucionet të shkëmbejnë reciprokisht të dhëna, si për çështje konkrete e probleme të ndryshme që kanë në ndjekje, me vëmendje të veçantë ndaj ruajtjes së sekretit hetimor, ashtu dhe për njohjen e gjendjes dhe veprimtarinë e elementëve kriminalë.

Neni 5

Administrimi i informacionit dhe i dokumentacionit

Çdo palë do ta trajtojë informacionin e marrë në zbatim të këtij Memorandumi në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, ligjit nr.8391, datë 28.10.1998, "Për Shërbimin Informativ Shtetëror", i ndryshuar, ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, ligjit nr.8457, datë 11.02.1999, "Për informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror", i ndryshuar, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 6

Personi i kontaktit

1. Palët në zbatim të këtij Memorandumi do të caktojnë nga një person kontakti.

2. Personat e kontaktit do të mbajnë vazhdimisht takime ndërmjet tyre në varësi të nevojës për shkëmbim informacioni dhe do të informojnë titullarin e institucionit në lidhje me zbatimin e këtij Memorandumi.
3. Personat e kontaktit do të organizojnë takimet periodike të titullarëve të tre institucioneve në përputhje me nenin 4, të këtij Memorandumi.
4. Secila Palë, brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij Memorandumi, njofton me shkrim për personin e kontaktit.

Neni 7

Dispozita të fundit

1. Secila palë merr përsipër njohjen e strukturave të varësisë me detyrimet e këtij Memorandumi, si dhe respektimin e zbatimit të detyrimeve që rrjedhin prej tij.
2. Për çdo rast të mosplotësimit të detyrimeve të mësipërme secila palë të informojë strukturat qendrore të linjave përkatëse.
3. Memorandumi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të tij dhe do të zbatohet me afat të pacaktuar. Në rast ndryshimi të kushteve që kanë diktuar nënshkrimin e tij, palët do të paraqesin dhe miratojnë ndryshimet përkatëse të këtij Memorandumi.
4. Memorandumi përpilohet në 3 (tre) kopje dhe secila palë mban nga një kopje të njëjtë.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME

PROKURORI I PËRGJITHSHËM



DREJTORI I SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT

